



**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE (KQZ)**, në mbështetje të nenit 64, paragrafi 2, nënparagrafi 2.1. dhe 2.2. dhe nenet 13, 14 dhe 18 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP) dhe neneve 13, 20 dhe 29.2 të Ligjit nr. 03/072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës (LZL) dhe nenit 17 të Ligjit Nr. 03/L-174 për Financimin e Subjekteve Politike, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-058 dhe Ligjin Nr. 04/L-122, me datën 06.03.2024, miraton këtë:

## **RREGULLORE ZGJEDHORE NR. 01/2024**

### **REGJISTRIMI DHE FUNKSIONIMI I PARTIVE POLITIKE**

#### **Neni 1**

#### **Qëllimi**

Kjo Rregullore përcakton procedurat për regjistrimin e partive politike, refuzimin e kërkesës për regjistrim, ankesat, përmbajtjen e statutit të partisë, zgjedhjet e brendshme, pezullimin, çregjistrimin e partive politike dhe obligimet ligjore ndaj KQZ.

#### **Neni 2**

#### **Regjistrimi i partive politike**

1. Partia politike mund të paraqitet për regjistrim duke dorëzuar në Zyrën për Regjistrimin, Certifikimi dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike (Zyra):
  - 1.1. Aplikacionin e plotësuar në formën siç është përshkruar në Shtojcën që i përfshinë të dhënat, me sa vijon:
    - 1.1.1. emrin zyrtar të partisë politike, akronimin, adresën, komunën, numrin e telefonit dhe kodin postar;
    - 1.1.2. të dhënat për kryetarin e partisë politike: emrin, mbiemrin, adresën dhe numrin e telefonit, adresën elektronike dhe komunën e banimit;
    - 1.1.3. të dhënat për personin kontaktues të partisë politike: emrin, mbiemrin, adresën dhe numrin e telefonit, adresën elektronike dhe komunën e banimit;

- 1.1.3.1. Personi kontaktues do të jetë personi i autorizuar për të komunikuar me Zyrën për çështjet që kanë të bëjnë me aktivitetet e rregullta vjetore të partisë, dhe për aktivitetet zgjedhore.
    - 1.1.4. të dhënat e përfaqësuesit të autorizuar financiar të partisë politike: emrin, mbiemrin, adresën dhe numrin e telefonit, adresën elektronike dhe komunën e banimit;
      - 1.1.4.1. Përfaqësuesi financiar është personi i autorizuar për të komunikuar me Zyrën për çështjet që kanë të bëjnë me financimin e partisë politike.
    - 1.1.5. deklaratën e nënshkruar nga kryetari i partisë për të respektuar, dhe për t'iu përmbajtur kodit të mirësjelljes së partive politike;
  - 1.2. Statutin e partisë në përputhshmëri me nenin 11 të kësaj Rregulloreje në formë fizike dhe elektronike;
  - 1.3. Çfarëdo shkurtese apo shenje të partisë;
  - 1.4. Deklaratën e fundit financiare të partisë, që përshinë me sa vijon:
    - 1.4.1. dëshminë bankare për pagesën për regjistrim;
    - 1.4.2. deklaratën financiare të subjektit politik, ku tregohen donatorët që kontribuojnë për regjistrim;
    - 1.4.3. kontratën për shfrytëzim të hapësirës për zyrë apo dëshmi bankare për pagesa të qerasë.
  - 1.5. Aktin e themelimit të partisë politike, shtojca- II- Formulari i konventës/kuvendit themelues, që përmban deklaratën e përkatësisë etnike të cilën e përfaqëson iniciativa politike në qoftë se garon për vendet e garantuara;
  - 1.6. Emrin dhe adresën e së paku 500 përkrahësve të iniciativës politike të cilët banojnë në Kosovë, dhe gjenden në listën përfundimtare të votuesve (LPV): Shtojca III, në formë fizike dhe elektronike, që përshinë me sa vijon:
    - 1.6.1. Emrin dhe mbiemrin,
    - 1.6.2. datën e lindjes,
    - 1.6.3. Adresën,
    - 1.6.4. numrin e telefonit,
    - 1.6.5. numrin personal,
    - 1.6.6. nënshkrimin.

- 1.7. Programin politik të partisë që është paraqitur për regjistrim, në formë fizike dhe elektronike, të miratuar nga organi i saj më i lartë, ku paraqiten objektivat politike dhe aktivitetet e partisë, të cilat duhet të jenë në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, dhe LZP.
2. Të gjitha shqyrtimet e aplikimeve për regjistrim të partive politike të dorëzuara në Zyrë, do të pezullohen ditën e shpalljes së datës së zgjedhjeve nga Presidenti i Republikës së Kosovës. Shqyrtimi i aplikimeve për regjistrim të partive politike do të vazhdojë dhjetë (10) ditë pas certifikimit të rezultateve përfundimtare.
3. Nisma qytetare e cila ka fituar ulëse në Kuvendin e Kosovës për të realizuar të drejtat nga ligji në fuqi për financimin e subjekteve politike për përfitim nga fondi për përkrahje të subjekteve politike, duhet të regjistrohet si parti politike.
  - 3.1. Brenda tridhjetë (30) ditëve nga konstituimi i Kuvendit të Kosovës, nisma qytetare duhet të aplikojë për regjistrim si parti politike;
    - 3.1.1. Pas certifikimi të rezultateve përfundimtare nga KQZ, Zyra kontakton nismën qytetare dhe e njofton për procedurën e regjistrimit si parti politike.
  - 3.2. Aplikimi i nismës qytetare për regjistrim si parti politike, duhet të përmbajë të gjitha dokumentet të cilat janë përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, përveç nënparagrafit 1.4, pika 1 dhe 2, dhe nënparagrafit 1.6.
  - 3.3. Nëse nisma qytetare nuk aplikon për regjistrim si parti politike, privohet nga ndarja e fondit për mbështetjen e subjekteve politike.

### **Neni 3**

#### **Shqyrtimi i kërkesave**

1. Brenda tridhjetë (30) ditëve nga pranimi i aplikimit, Zyra e njofton KQZ për statusin e aplikimit, duke rekomanduar regjistrimin apo mosregjistrimin, ose duke sugjeruar dhe kërkuar korrigjime, përmirësime, plotësime apo ndryshime.
2. Zyra i shqyrton kërkesat brenda dhjetë (10) ditëve nga dita e pranimi të tyre.
3. Nëse kërkesa është e pakompletuar, apo nëse nevojiten të dhënat shtesë për shqyrtim të asaj kërkesë, Zyra do të kërkojë nga iniciativa për regjistrimin e partisë politike që të bëjë korrigjime, përmirësime, plotësime apo ndryshime brenda pesë (5) ditëve nga marrja e kërkesës nga Zyra.
4. Nëse Zyra e pranon si të kompletuar kërkesën e iniciativës politike për regjistrim, e shpallë atë në gjuhët zyrtare në Kosovë, në faqen zyrtare të internetit të KQZ, brenda shtatë (7) ditëve.

5. Secili qytetar i Republikës së Kosovës mund ta kundërshtojë kërkesën në bazë të një ose më shumë arsyeve të parashtruara në nenin 4 të kësaj Rregullore, me dorëzimin e kundërshtimeve me shkrim në Zyrë, së bashku me çfarëdo dëshmie apo materiali që mbështetë kundërshtimet brenda shtatë (7) ditëve nga shpallja e kërkesës nga paragrafi 4, i këtij neni.
6. Nëse nuk ka kundërshtime sipas paragrafit 5 të këtij neni dhe Zyra konstaton se nuk ka arsye për refuzimin e regjistrimit sipas nenit 4 të kësaj Rregulloreje, Zyra brenda tre (3) ditëve i rekomandon KQZ regjistrimin e partisë politike dhe për këtë e njofton partinë.
7. Nëse ka kundërshtime sipas paragrafit 5 të këtij neni, Zyra e njofton iniciativën politike lidhur me kundërshtimin në afat prej 24 orëve nga pranimi i kundërshtimit dhe kërkon sqarime shtesë nga iniciativa politike në afat prej tri (3) ditëve. Zyra e shqyrton kundërshtimin dhe sqarimet shtesë brenda tri (3) ditëve nga pranimi i kundërshtimit dhe i rekomandon KQZ miratimin apo refuzimin e kërkesës për regjistrim. Nëse KQZ e miraton kërkesën për regjistrimin e partisë politike, i njofton partinë dhe palët që kanë paraqitur kundërshtim për vendimin përmes Zyrës.
8. Pas vendimit të KQZ, Zyra menjëherë e njofton iniciativën politike të paraqitur për regjistrim dhe palët që kanë paraqitur kundërshtimin lidhur me refuzimin e kërkesës së saj, dhe arsyetimin për refuzim.
9. Njoftimi për refuzimin e kërkesës për regjistrim që i dërgohet iniciativës, përfshin arsyet me shkrim për refuzimin dhe informon iniciativën për mos regjistrimin e partisë politike dhe për të drejtën e saj që të ankohet sipas nenit 8 të kësaj Rregullore.
10. Partia politike që përfshihet në Regjistrin e partive politike, fiton statusin e personit juridik me zotësi për të pasur pasuri, për të lidhur kontrata, për të paditur dhe për t'u paditur.
11. Aplikimi për regjistrim të partisë politike mund të tërhiqet në çdo kohë para nxjerrjes së vendimit për regjistrim të partisë politike nga KQZ, duke e dorëzuar një kërkesë me shkrim për tërheqje të aplikimit, të nënshkruar nga të gjithë personat që kanë nënshkruar fillimisht aktin e themelimit të partisë politike, Shtojca II.

#### **Neni 4**

##### **Arsyet për refuzimin e regjistrimit**

1. Me rekomandim nga Zyra, KQZ e refuzon kërkesën e iniciativës politike për regjistrim, nëse:
  - 1.1. Dokumentet e regjistrimit, përfshirë edhe statutin e partisë, nuk i plotësojnë kërkesat e kësaj Rregullore, janë në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe LZP;
  - 1.2. iniciativa paraqet emër, akronim ose simbol që, sipas vlerësimit të Zyrës, mund të nxisë urrejtje ndëretnike, religjioze apo gjinore;

- 1.3. në dokumentet e themelimit të saj, shprehet qëllimi për përdorimin e dhunës për marrjen e pushtetit si dhe shprehet nxitja dhe përkrahja e urrejtjes racore fetare, etnike etj;
- 1.4. është e domosdoshme për të siguruar rendin publik, shëndetin publik, sigurinë kombëtare, parandalimin e çrregullimeve, dhunës dhe krimit, ose mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve;
- 1.5. iniciativa paraqitet për regjistrim me emër, akronim ose simbol që është i njëjtë apo i ngjashëm me simbolin e partisë të regjistruar më herët nga KQZ;
- 1.6. nëse dy aplikacione për regjistrim të iniciativës politike me emër, akronim apo me simbole të njëjta apo të ngjashme, Zyra vendos se cila prej tyre ka të drejtë të regjistrohet me emrin apo simbolin e saj, duke marrë parasysh rrethanat e përgjithshme, si:
  - 1.6.1. kohën kur secila iniciativë e ka dorëzuar kërkesën;
  - 1.6.2. kohën kur secila iniciativë e ka përdorur së pari emrin ose simbolin e saj.
- 1.7. Iniciativa politik është krijuar jashtë territorit të Republikës së Kosovës.

## **Neni 5**

### **Pezullimi i partive politike të regjistruara**

1. KQZ e pezullon nga regjistri partinë politike:
  - 1.1. Për mosmbajtjen e konventës/kuvendit të partisë politike, në pajtim me nenin 12, paragrafi 1 të kësaj Rregulloreje;
    - 1.1.1. me vendimin e KQZ për pezullim, partia politike obligohet që në afat prej 45 ditë të mbajë konventën/kuvendin e saj;
    - 1.1.2. subjekti politik obligohet që së paku pesë (5) ditë para mbajtjes së kuvendit, ta njoftoj Zyrën për mbajtjen e kuvendit/ konventës.
  - 1.2. Zyra, menjëherë pas pezullimit të regjistrimit të partisë politike, ndërmerr veprimet si në vijim:
    - 1.2.1. Shënon pezullimin e saj në regjistrin e partive politike;
  - 1.3. Partia politike, regjistrimi i së cilës është pezulluar, nuk certifikohet nga KQZ për të marrë pjesë në zgjedhje.

## **Neni 6**

### **Vazhdimi i regjistrimit**

1. Partia politike e regjistruar duhet të dorëzojë formularin për të vazhduar regjistrimin e saj, në formë elektronike ose në formë fizike të nënshkruar, jo më vonë se 31 marsi i vitit kalendarik, shtojca - IV.
  - 1.1. Partia politike e regjistruar, formularin e vazhdimin për regjistrim duhet ta dorëzojë në Zyrë, prej datës 1 mars, deri me datën 31 mars të çdo viti kalendarik.

## **Neni 7**

### **Çregjistrimi i partive politike nga regjistri**

1. Me vendimin e KQZ, Zyra e largon partinë politike nga regjistri i partive politike, nëse:
  - 1.1. Sanksioni penal kundër subjektit politik të regjistruar do të thotë çregjistrim i atij subjekti politik, siç përcaktohet nga gjykata;
  - 1.2. partia politike e regjistruar, e cila në Zyrë nuk dorëzon formularin për ta vazhduar regjistrimin deri me 31 mars të çdo viti kalendarik. Në rast të dështimit për t'u reregjistruar në përputhje me këtë Rregullore, partia politike do të largohet nga regjistri i partive politike;
  - 1.3. vullnetarisht, është shpërndarë në pajtim me statutin e saj;
  - 1.4. ka qenë e pezulluar sipas dispozitave të nenit 5 të kësaj Rregullore dhe nuk ka vepruar sipas afatit të dhënë shtesë, paraprakisht të përcaktuar me vendimin e KQZ për pezullim;
  - 1.5. pas regjistrimit, ndryshon aktet e brendshme të organizimit të saj, të cilat përmbajnë elemente të definuara në nenin 4 të kësaj Rregulloreje.
2. Partia politike e cila është çregjistruar nga regjistri i partive politike në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, i pushon statusi i personit juridik dhe konsiderohet e shpërndarë, kurse ndarja e pasurisë së saj bëhet në pajtim me statutin e partisë.
3. Nëse nuk ka marrëveshje të subjektit politik të rregulluar me statutin e partisë, ndarja e pasurisë bëhet nga gjykata kompetente.

## **Neni 8**

### **E drejta për ankesë**

Subjekti politik përmes personit të autorizuar, ka mundësi të ushtrojë ankesë kundër vendimit të KQZ për refuzim të regjistrimit apo për çregjistrim në PZAP, brenda pesë (5) ditë pune pas publikimit të vendimit.

## **Neni 9**

### **Njoftimi për ndryshimet përmes kuvendit/ konventës**

1. Partia e regjistruar politike e njofton Zyrën brenda pesë (5) ditëve të punës nga mbajtja e konventës/kuvendit: Shtojca V - Formulari për njoftimin e ndryshimeve të partisë politike, nëse ajo:
  - 1.1. Ndërron kryetarin, zyrtarin për financa të partisë ose anëtarësinë e organit të saj më të lartë ekzekutiv;
  - 1.2. për çfarëdo ndryshimesh sa i përket kryetarit apo zyrtarit për financa të partisë politike, Zyra njoftohet brenda pesë (5) ditëve të punës pas bërjes së ndryshimeve;
  - 1.3. ndryshon emrin e saj zyrtar, akronimin ose simbolin. Ndryshimet e tilla do të koordinohen paraprakisht me Zyrën, duke marrë parasysh kërkesat nga neni 4, paragrafi 1 i kësaj Rregullore;
  - 1.4. ndryshon statutin apo programin e saj politik;
  - 1.5. shpërndahet vullnetarisht;
  - 1.6. ndryshon identitetin, adresën apo numrin e telefonit të personit për kontaktim, përfaqësuesit financiar ose përfaqësuesit e partisë në çdo komunë ku partia është aktive;
  - 1.7. hap apo mbyll një degë të partisë.
2. Partia e regjistruar politike, së bashku me njoftimin për çdo ndryshim të paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, dorëzon edhe kopjen e procesverbalit të mbledhjes ose të procedurës me të cilën është miratuar ndryshimi, e cila duhet të jetë e vërtetuar nga kryetari i partisë.
3. Partia e regjistruar politike, së bashku me njoftimin për çdo ndryshim të statutit apo programit politik të partisë, i dorëzon Zyrës kopjen e statutit apo të programit politik të ndryshuar.

## **Neni 10**

### **Njoftimi për ndryshimet e të dhënave tjera vjetore**

1. Partia e regjistruar politike në mënyrë të vazhdueshme i kompletton dhe ia dorëzon Zyrës të dhënat e ndryshuara, në platformën elektronike ose në formën fizike të nënshkruar, duke identifikuar të dhënat e ndryshuara vjetore, brenda pesë (5) ditësh nga momenti i ndryshimit shtojca -V, si në vijim:
  - 1.1. Emrin dhe mbiemrin, adresën aktuale të kryetarit të partisë, të anëtarëve të organit më të lartë ekzekutiv, të personit për kontaktim, të përfaqësuesit financiar dhe të përfaqësuesit të partisë, në çdo komunë ku partia është aktive;

- 1.2. adresën aktuale të selisë qendrore të partisë politike;
  - 1.3. adresat aktuale të të gjitha zyreve të degëve lokale të partisë në Kosovë;
  - 1.4. çdo ndryshim të statutit apo të programit politik të partisë, që është bërë gjatë vitit paraprak.
2. Nëse Zyra ka vërejtur që partia politike ka dorëzuar formularin me të dhënat jo të plota për organin ekzekutiv, atëherë partia politike obligohet që brenda pesë (5) ditëve të punës nga njoftimi, t'i komplotoj të dhënat për organin më të lartë ekzekutiv.
  3. Zyra përmes Sekretariatit të KQZ (SKQZ), mund të verifikojë të dhënat për zyret e partive politike nëpër komuna, i cili duhet të përfundoj brenda katërmbëdhjetë (14) ditëve kalendarike nga parashtrimi i kërkesës.

## **Neni 11**

### **Statuti i partisë**

1. Çdo parti e regjistruar politike ka statutin me të cilin rregullohen veprimet e partisë si tërësi.
2. Statuti i partisë së regjistruar politike përfshin, por nuk kufizohet vetëm në:
  - 2.1. Procedurat përmes të cilave qytetarët mund të bëhen anëtarë dhe të pushojnë të jenë anëtarë të partisë, si dhe të drejtat dhe përgjegjësitë e anëtarëve;
  - 2.2. procedurat që duhet zbatuar për ndryshimin e statutit ose të programit politik të partisë;
  - 2.3. procedurat që duhet zbatuar për zgjedhjen e kryetarit, të anëtarëve të organit më të lartë ekzekutiv, apo të zyrtarëve tjerë të zgjedhur të partisë;
  - 2.4. procedurat dhe metodat për ushtrimin e kontrollit të brendshëm financiar të tyre dhe, me qëllim të parandalimit dhe luftimit të praktikave korruptive, ngritjes dhe forcimit të menaxhimit financiar dhe transparencës, të zhvillojnë mekanizmat e kontrollit të brendshëm financiar;
  - 2.5. përcaktimin e pagesës për anëtarësi apo të lirojë anëtarët nga pagesa e anëtarësisë;
  - 2.6. krijimin e një organi për zgjidhjen e kontesteve brenda partisë, lidhur me interpretimin e statutit;
  - 2.7. të ketë të rregulluar përfaqësimin gjinor në organet e saj të brendshme;
  - 2.8. kalimi i pasurisë së mbetur pas shlyerjes së të gjitha borxheve, me rastin e shuarjes së partisë;



2.9. rregulloren e punës që duhet zbatuar në kuvendet e rregullta dhe të jashtëzakonshme të anëtarëve të partisë, duke përfshirë edhe sigurimin e kuorunit, të rendit të ditës dhe të vendimmarrjes;

2.10. procedurat e shuarjes.

3. Ndryshimi në statutin e partisë së regjistruar politike që nuk përputhet me kërkesat e kësaj Rregulloreje, është i pavlefshëm.
4. Statuti i partisë së regjistruar politike është dokument publik dhe publikohet të paktën në njërën nga gjuhët zyrtare në Kosovë, në faqen elektronike të partisë politike.

## **Neni 12**

### **Zgjedhja e organeve të partisë politike**

1. Partia e regjistruar politike, brenda gjashtë (6) muajve nga data e regjistrimit të partisë dhe pastaj së paku çdo dyzetetë (48) muaj, duhet ta mbajë konventën/ kuvendin zgjedhor, ku zgjedh kryetarin dhe organet e tjera të partisë në mënyrë demokratike dhe transparente, ashtu siç e ka të rregulluar me statutin e saj të dorëzuar në KQZ.
2. Secili anëtar i partisë së regjistruar politike, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo përmes delegatit të caktuar sipas procedurës përkatëse, ka votë të barabartë në të gjitha vendimet e marra nga Konventa/kuvendi, duke përfshirë zgjedhjen e kryetarit dhe të organit më të lartë ekzekutiv të partisë.
3. Partia e regjistruar politike, fton Zyrën për ta vëzhguar zgjedhjen e organeve të partisë në afat prej 5 ditë pune nga data e caktuar për mbajtjen e konventës/ kuvendit zgjedhor.
4. Partia e regjistruar politike njofton Zyrën në afat prej 5 ditë pune nga dita e mbajtjes së konventës/ kuvendit zgjedhor të saj, për ndryshimet, listën e delegatëve pjesëmarrës të konventës/ kuvendit së organizuar, dhe dorëzon në Zyrë kopjen e procesverbalit dhe të gjitha materialet që kërkohen me formularin për njoftimin e ndryshimeve shtojca -V, të cilat duhet të vërtetohen nga kryetari i partisë.
5. Zyra mund të kërkojë nga SKQZ, vëzhgimin e kuvendit të partisë politike që ka selinë qendrore jashtë Komunës së Prishtinës, i cili përgadit raportin për vëzhgimin e kuvendit zgjedhor, si në shtojcën nr. VI.
6. Në rast se partia politike certifikohet për të marrë pjesë në zgjedhjet lokale apo qendrore, atëherë e njëjta, nuk obligohet që të zhvilloj kuvendin zgjedhor, deri në tre (3) muaj pas certifikimit të rezultateve nga KQZ.
7. Partia politike mund të kërkojë afat shtesë për mbajtjen e Konventës zgjedhore të partisë politike, nëse:

- 7.1. Kërkesa për afat shtesë dorëzohet të paktën 10 ditë pune para afatit të fundit për mbajtje të konventës në rast se mbajtja e konventës pamundësohet prej:
  - 7.1.1. gjendjes emergjente shëndetësore të shpallur nga institucionet shtetërore;
  - 7.1.2. fatkeqësive natyrore;
  - 7.1.3. gjendjes së jashtëzakonshme të shpallur nga institucionet shtetërore.
- 7.2. Në rrethanat sipas nën paragrafit 7.1, partive politike u jepet një afat shtesë deri në tre (3) muaj për mbajtje të kuvendit, pas përfundimit të rrethanave të krijuara.
- 7.3. Zyra shqyrton kërkesat sipas paragrafit 1 të këtij neni.
- 7.4. Nëse gjendja sipas paragrafit 7.1 të këtij neni vazhdon më gjatë se gjashtë (6) muaj, partia politike mund të dorëzojë kërkesë të re, e cila shqyrtohet nga KQZ.

### **Neni 13**

#### **Qasja në dokumentet e partive politike**

1. Zyra përditëson dhe mirëmban dokumentet e partive politike, si në vijim:
  - 1.1. Programin;
  - 1.2. statutin;
  - 1.3. verzionet përfundimtare të të gjitha raporteve financiare vjetore të dorëzuara në Zyrë, së bashku me deklaratën e auditimit të subjekteve politike dhe regjistrin e donatorëve, sipas Ligjit për Financimin e Subjekteve Politike.
2. Qasja në dokumentacionin e regjistrimit të partive politike, bëhet në përputhje me Ligjin Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike.

### **Neni 14**

#### **Gjobat**

1. KQZ sanksionon partitë e regjistruara politike për shkelje të kësaj Rregullore, bazuar në dispozitat e LZP-së, dhe LFSP.
2. Pavarësisht pezullimit, partia politike obligohet të paguajë gjobën e shqiptuar.
3. Shqiptimi i gjobës nuk paragjykon asnjë sanksion penal që mund të zbatohet. Rastet të cilat mund të nënkuptojnë vepër penale, do të përcillen nga KQZ në Zyrën e Prokurorit të Shtetit.
4. Gjobat e mbledhura nga Zyra, barten në Buxhetin e Kosovës.

5. KQZ, sipas rekomandimit të Zyrës, i gjobitë subjektet politike për mos dorëzim të dokumentacionit të kërkuar, sipas nenit 9, 10 dhe 12 të kësaj Rregulloreje, sipas kriterit të përfaqësimit dhe afateve.
  - 5.1. Subjektet politike të cilat janë të përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës, gjobiten për mos deklarim, në shumën prej 1,000 €;
  - 5.2. partitë politike të regjistruara, të cilat nuk janë të përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës, gjobiten për vonesën, në shumën prej 500 €.

## **Neni 15**

### **Sanksionet tjera**

1. Subjektet politike të gjobitura sipas nenit 14 të kësaj rregulloreje, obligohen që në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga shqiptimi i gjobës, t'i dorëzojnë dokumentet e kërkuara.
2. Në rast se, subjekti politik nuk dorëzon dokumentet e kërkuara brenda këtij afati, sipas paragrafit 1 të këtij neni, subjekti politik nuk certifikohet për zgjedhje qendrore apo lokale.

## **Neni 16**

### **Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare**

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohet Rregulla nr. 01/2023 për Regjistrimin dhe Funksionimin e partive politike.
2. Iniciativa qytetare që ka fituar ulëse në Kuvendin e Kosovës para hyrjes në fuqi të LZP, obligohet që brenda gjashtëdhjetë (60) ditë pas miratimit të kësaj rregullore, të regjistrohet si parti politike.
3. Pjesë përbërëse të kësaj Rregullore, janë shtojcat:
  - 3.1. shtojca - I Formulari i regjistrimit të partisë politike;
  - 3.2. shtojca - II Formulari i konventës/kuvendit themelues;
  - 3.3. shtojca - III Lista e përkrahësve për regjistrim të partisë politike;
  - 3.4. shtojca - IV Formulari për vazhdimin e regjistrimit të partisë politike;
  - 3.5. shtojca - V Formulari i azhurnimit;
  - 3.6. shtojca - VI Formulari për njoftimin e ndryshimeve të partisë politike;
  - 3.7. shtojca - VII – Raporti për vëzhgim të kuvendit zgjedhor.

4. Brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, Zyra obligohet që ta hartojë procedurën për regjistrimin e partive politike.

## **Neni 17**

### **Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit.

**Kryesues**

**Komisioni Qendror i Zgjedhjeve**

---

**Kreshnik Radoniqi**